



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 593, datë 09.10.2024

**PËR
CAKTIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT TË GJYQTARES
ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës datë 04.10.2024 të gjyqtares znj. {...}, protokolluar pranë Këshillit me aktin nr. 4840, datë 07.10.2024, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.
2. Caktimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në 2 (dy) vjet, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përfundimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që kanë kaluar në seancë gjyqësore.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR